



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS SPANJOLLE



PROGRAMI I LËNDËS
Gjuha C 1

Ngarkesa: numri i krediteve 3;30 seminare

Viti / Semestri : Viti I, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë me zgjedhje

Programi i studimit: Master ‘‘Përkthim Teknik -Letrar dhe Interpretim’’

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektiva të përgjithshme:

Aspekti gjuhësor dhe profesional është orientuar mbi zbatueshmërinë e dy objektivave: Të evidentojë dhe të harmonizojë njohuritë e përfutuara në komunikimin gojor e shkrimor të gjuhës spanjolle (Niveli C1) dhe në anën tjetër, do të ushtrohen dhe thellohen njohuritë e lidhura me aspekte të thelluara profesionale. Si rrjedhojë, situatat e komunikimit gjuhësor do të kenë referenca konkrete mes aspektit profesional dhe atij të përditshëm. Studenti duhet të jetë i aftë të përvetësojë në nivel të lartë gramatikën, ortografinë, shqiptimin, ndërtimin e fjalisë në spanjisht; të përshkruajë me fjalor të pasur situata të ndryshme ndërkomunikuese; të organizojë informacionin e marrë; të nxisë krijimtarinë sistematike dhe të organizojë punën në grup; të njohë zakonet e traditave të popullit spanjoll. Gjithashtu studenti i *Masterit Shkencor* duhet të jetë i aftë të kryejë e të përmbushë korrespondenca ndërgjuhësore me kolegë të të njëjtë profil.

Objektivat specifikë lëndorë:

1. Duhet të arrijë komunikim të lartë në gjuhën spanjolle me bashkëfolës hispanistë, duke analizuar kërkesat e nevojat e nxënësit të ardhshëm, duke i ofruar përgjigje, shembuj e shpjegime të sakta.
2. Gjithashtu studentët duhet të simulojnë organizimin e vizitave sociokulturore e didaktike, duke qenë të aftë të respektojnë e përmbushin metodologjinë e strategjinë bashkohore në nxitjen dhe mësimdhënien e gjuhës së huaj;
3. Studentët duhet të jenë të aftë të negociojnë e diskutojnë në kuadrin e debatit mësimor-shkencor, të zhvillojnë, thellojnë e aktualizojnë suksesshëm dygjuhësinë profesionale.

Rezultatet e pritshme:

1. Të jenë të aftë të kalojnë nga niveli B2 i gramatikës në nivelin C.
2. Të jenë të aftë të komunikojnë rrjedhshëm në gjuhën spanjolle, të përcjellin, përjasin, përkuftizojnë, analizojnë, argumentojnë e krahasojnë tekste të nivelit mbimesatar në spanjisht mbi tematika të ndryshme. Ata do të shkruajnë saktë e pa gabime gramatikore mbi temat e lartpërmendura.